

URDHËR
Nr. 447, datë 10.7.2023

**PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PËRGJITHSHËM TË PËRMBARUESVE
GJYQËSORË TË SHËRBIMIT PËRMBARIMOR GJYQËSOR SHTETËROR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, dhe të nenit 11, pika 1, të ligjit nr. 8/2023, “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror”,

URDHËROJ:

1. Numri i përgjithshëm i përmbaruesve gjyqësorë të Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror të jetë 144 (njëqind e dyzet e katër).
 2. Përfshihet, për vitin 2023, numri i përgjithshëm i përmbaruesve gjyqësorë të Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror të jetë 78 (shtatëdhjetë e tetë).
 3. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.
 4. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit në Ministrinë e Drejtësisë për marrjen e masave të nevojshme për njoftimin e këtij urdhri.
- Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja